

REZISTENCA JOVIOLENTE AKTIVE NË KOSOVË: PROTESTAT
STUDENTORE TË VITIT 1997

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I HISTORISË- KOHA E RE

NGA

OKTAJ HASANI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

KORRIK, 2022

REZYME E TEMËS SË DIPLOMËS

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Selim Bezeraj

Kandidati: Oktaj Hasani

Tema: *Rezistenca joviolente aktive në Kosovë: Protestat studentore të vitit 1997*

Qëllimi i këtij studimi është trajtimi i temës: “Rezistenca joviolente aktive në Kosovë: Protestat studentore të vitit 1997”. Në fillim të këtij punimi është bërë grumbullimi i literaturës adekuate dhe janë bërë hulumtime të tjera lidhur me literaturën relevante për temën bosht të çështjes së shtruar për studim. Punimi në fjalë përmban tre kapituj:

1. Në kapitullin e parë kemi trajtuar çështje të cilat ndërlidhen me protestën e 1 tetorit 1997 të organizuar nga Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të Prishtinës. Në kuadër të këtij kapitulli janë trajtuar sfidat për realizimin e protestës së 1 tetorit 1997 dhe vështirësitë që studentët patën për realizimin e kësaj proteste. Në pika të shkurta është trajtuar edhe nisja e protestës dhe zhvillimi i saj deri tek ndërhyrja e policisë serbe.
2. Në kapitullin e dytë është trajtuar në veçanti dita e zhvillimit të protestës dhe dhuna që policia serbe e përdori mbi studentët protestues më 1 tetor 1997 në Kosovë. Ndërsa, po ashtu këtu kemi trajtuar edhe qëndrimin e ndërkombëtarëve mbi protestën studentore të 1 tetorit 1997.
3. Në kapitullin e tretë, është trajtuar periudha e postprotestës së 1 tetorit 1997, vizitat e studentëve të UPSUP-së jashtë vendit si dhe organizimi i protestave të 29 tetorit 1997 dhe 30 dhjetorit 1997.

Në këtë hulumtim sa i përket metodave hulumtuese kemi përdorur metodat kualitative dhe kuantitative. Ndërsa për ta finalizuar hulumtimin në fjalë kemi përdorur metodat analitike dhe krahasimore. Duhet theksuar se pjesa e fundit e punimit përbëhet nga: Përfundimi dhe pjesa e Burimeve dhe Literaturës. Në të parën kemi radhitur disa konkluzione të cilat kanë qenë fryt i punës hulumtuese sistematike mbi temën e trajtuar, ndërsa në të dytën janë radhitur burimet mbi bazën e të cilit është kryer ky punim.

Në kuadër të këtij punimi kemi ngritur tre hipoteza:

1. *Protestat studentore të 1 tetorit 1997, a e kanë ndryshuar qëndrimin e faktorit ndërkombëtar mbi organizimin e protestave masovike në Kosovë dhe a kanë*

ndikuar që diplomatët e huaj tashmë të merren më intensivisht me çështjen e Kosovës?

- 2. Protestat studentore të 1 tetorit 1997, a kanë arritur ta shpërfaqin para botës regjimin e Millosheviçit mbi shqiptarët e Kosovës?*
- 3. A ka pasur bashkëpunime mes studentëve dhe UCK-së, në realizimin e protestave studentore të vitit 1997?*

Vërtetimin e të cilave po ashtu e kemi vendosur tek pjesa e përfundimit!